




Pranuar / Dorezuar Prijmjeno/Prudato Received/Delivery	10.08.2022	viti god year	
Organ /Hjesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Pr Prot Prot.No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKGJK/IV	4646/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.652/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.652/2022 të datës 25.07.2022, të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë _____ Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "*Pezullim parandalues*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 10.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.652/2022 e datës 25.07.2022 e parashtruar nga ankuesi _____

-A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (SKGJK), me datën 25.07.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4273/2022 të regjistruar me shenjen A.nr.652/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.22/2022 të datës 10.06.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA) të SKGJK-se, për shkak të shkeljes se ligjit material dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjen faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat Rregullore Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 26.07.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa me datë 27.07.2022 ka pranuar përgjigjeje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 4273/2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.22/2022 të datës 01.06.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin DS-523/2022 të datës 28.04.2022 për pezullim parandalues; Vendimin me numër 128/19 të datës 05.03.2019 për pezullim parandalues; Organogramin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe degët e saj; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e administratorit të gjykatës të Gjykatës të datës 15.09.2015; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e udhëheqësit të zyrës për menaxhimin e lëndëve të datës 15.09.2015; Formularin e rezultateve në punë për vitin 2020 të datës 31.12.2020 për ankuesin; Ankesën e ankuesit Nr.01/1019 të datës 11.05.2022 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 27.07.2022 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me shkresat për provat e bashkangjitura në lëndë; Vendimin DS-464/2022 të datës 12.04.2022 lidhur me harmonizimin e koeficientit të ankuesit; Vendimin Nr.01/1195 të datës 10.06.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për ankuesin; E-mailin zyrtar të datës 13.05.2022 lidhur me kërkesën për informacion; E-mailin zyrtar të datës 12.05.2022 lidhur me kërkesën për informacion; E-mailin zyrtar të datës 28.04.2022; Fletë kthesën e postës nën numër 01/1195 të datës 20.06.2022 lidhur me pranimin e vendimit nga ankuesi; Vendimin me numër 128/19 të datës 05.03.2019 për pezullimin parandalues për ankuesin; Vendimin K.D 05/2020 të datës 10.05.2020 nga Komisioni Disiplinor i SKGJK-së; Vendimin Nr.01/598 të datës 12.03.2015 të Komisionit Disiplinor të SKGJK-së; Aktgjykimin P.nr.291/19 të datës 15.01.2020 të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa lejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Vendimin DS-464 të datës 12.04.2022 rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Referent" në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së, me datë 28.04.2022 me Vendimin DS-523/2022 ka pezulluar ankuesin nga detyra me 50% të pagës, pas pranimin të njoftimit zyrtar nga Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, se i njëjti me datën 27.04.2022, gjatë orarit të punës ka kryer veprime që bien ndesh me përshkrimin e detyrave të punës dhe kodit të etikës, duke sulmuar fizikisht ushtruesin e detyrës së Administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe se ndaj tij është iniciuar procedurë penale në Prokurorinë Themelore në Prishtinë nën dyshimin për kryerje të veprës penale "Sulm ndaj personit zyrtar".

I pakënaqur me vendimin për pezullimin e parandaluar, ankuesi me datën 11.05.2022 ka parashtruar ankesën me Nr.01/1019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së. Ky i fundit me datën 10.06.2022 ka nxjerrë Vendimin KA.nr.22/2022, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Kundër Vendimit KA.nr.22/2022 të datës 10.06.2022 të KZKA-se, ankuesi me datë 25.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me



pretendimin ankimor se vendimi i kontestuar është nxjerr përmes shkeljes se ligjit material dhe se nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejte gjendja faktike.


Kolegji i Këshillit, bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Fletë kthesën nr.01/1195 nga Posta e Kosovës, ka konstatuar se ankuesi me datë 20.06.2022 ka pranuar Vendimin KA.nr.22/2022 të datës 10.06.2022 të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër këtij vendimi e ka parashtruar me datë 25.07.2022, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ"*.

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa A.nr.652/2022 e datës 25.07.2022 është e palejuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.652/2022, datë 29.07.2022

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse


Jeton Koca
Kryetar i Kolegjit


Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.